



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gjiçane
Municipal Gjiçan
Gilan Belediyesi

DREJTORIA E ARSIMIT

Në bazë të nenit 5 pika d të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, si dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ 3/2009, për procedurat e zgjedhjes së drejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese, Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjiçan, shpall :

K O N K U R S PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

- I- Shkolla e Mesme Gjymnazi “Zenel Hajdini” në Gjiçan
- Pozita : Drejtor

Përshkrimi i punëve : Udhëheqë institucionin dhe është përgjegjës për :

- Zbatimin e ligjshmërisë,
- detyrat e caktuara për zgjedhjen, vlerësimin, disiplinën dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët e tjerë të arsimit,
- përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit të informatave për menaxhimin e arsimit dhe respektimin e kodeve të ndërlikuara të praktikës,
- caktimin e masave disiplinore ndaj nxënësve,
- detyrat lidhur me kurrikulumin
- Planifikimin, udhëheqjen dhe koordinimin e të gjitha aktiviteteve në Institucion,
- Zhvillimin e një plani afatmesëm dhe aftëgjatë për aktivitetin e Institucionit,
- çështjet e tjera që rregullohen përmes këtij ligji.

Kushtet :

- Të jenë shtetas i Republikës së Kosovës,
- Të kenë të kryer njërin nga fakultetet përkatëse të licencuara të Universitetit të Prishtinës ose të fakulteteve private të akredituara dhe të licencuara nga MASHT,
- Të kenë më së paku 3 (tri) vite përvojë pune në arsim.

Dokumentet e nevojshme: Certifikata e lindjes, diploma e fakultetit të kryer, kopja e letërnjoftimit, dëshmia për përvojën e punës, CV-në sipas modelit të MASHI-it, Certifikatat e trajnimeve të zhvilluara, programin zhvillimor të Institucionit për të cilin ka konkurruar (në më së shumti pesë faqe tekst me 30 rreshta të letrës të formatit A4), rekomandimin nga një person apo institucion publik-kredibil si dhe Certifikatën shëndetësore me të cilën dëshmohet gjendja shëndetësore. Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të shqyrtohet, ndërsa në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët nga lista e ngushtë.

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës si dhe nëpër kolegjet private brenda Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këto vende të punës, duhen që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me udhëzimin administrativ, nr. 8/2010 të datës 22.06.2010, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Koeficienti 8.4

Kohëzgjatja e kontratës: sipas udhëzimit administrativ 3/2009

Konkursi mbetet i hapur për aplikim 15 ditë nga dita e shpalljes në gazeta zyrtare.

Të gjithë kandidatët e interesuar duhet t'i marrin aplikacionet dhe të plotësuara të dorëzohen pranë Qendrës për Shërbim të Qytetarëve në Gjiçan.

Drejtori

Bujar Nevzati